

# Rumeli

RUMELİ İSLÂM ARAŞTIRMALARI DERGİSİ

مجلة روم ايلي للبحوث الإسلامية | Rumeli Journal of Islamic Studies

eISSN: 3023 - 8498 • Yıl/Year: 2024 • Sonbahar/Autumn • Sayı/Issue: 14



TRAKYA  
ÜNİVERSİTELER BİRLİĞİ  
İLAHİYAT FAKÜLTELERİ

# RUMELİ

İslâm Arařtırmaları Dergisi

مجلة روم ايلي للبحوث الإسلامية / Journal of Islamic Studies

Yıl / Year: 2024 – Sonbahar / Autumn – Sayı / Issue: 14



ISSN: 2564-7903  
eISSN: 3023-8498

Dergimizin Tarandıđı Veritabanı ve İndeksler:



## RUMELİ İslâm Arařtırmaları Dergisi | Journal of Islamic Studies

مجلة روم ايلي للبحوث الإسلامية

ISSN: 2564-7903

eISSN: 3023-8498

**Kapsam | Scope:** Dinî Arařtırmalar, İslam Arařtırmaları, Balkan Arařtırmaları / Religious Studies, Islamic Studies, Balkan Studies

**Periyot | Period:** Yılda 2 Sayı (30 Nisan & 31 Ekim) / Biannual (30 April & 31 October)

**Yayın Dili | Language Publication:** Türkçe & İngilizce & Arapça & Arnavutça & Boşnakça / Turkish & English & Arabic & Albanian & Bosnian

**Rumeli İslâm Arařtırmaları Dergisi** Uluslararası bilimsel hakemli bir dergidir.  
**Rumeli Journal of Islamic Studies** is a international peer-reviewed academic journal.

### Yayıncı / Publisher

Trakya Üniversitesi Matbaası  
Edirne Teknik Bilimler MYO Sarayıçi Yerleşkesi Edirne, TÜRKİYE

### Amblem ve Kapak Tasarımı | Emblem and Cover Design

Dr. Ömer Kasım Kahya

### Grafik Tasarım ve Mizanpaj | Graphic Design and Layout

Arş. Gör. Muhammet Küçükbaltaoğlu

Rumeli İslâm Arařtırmaları Dergisi, Creative Commons Atıf 4.0 International License (CC BY NC) ile lisanslanmıştır. Yazarlar dergide yayınlanan çalışmalarının telif hakkına sahiptirler ve çalışmalarını CC BY-NC 4.0 lisansı altında yayımlanmaktadır.

Rumeli Journal of Islamic Studies is licensed under a Creative Commons Attribution 4.0 International License (CC BY NC). Authors publishing with the journal retain the copyright to their work licensed under the CC BY-NC 4.0.

Rumeli İslâm Arařtırmaları Dergisi'nde yayımlanan yazıların tüm içerik sorumluluğu yazarlarına aittir.

All the responsibility for the content of the papers published in Rumeli Journal of Islamic Studies belongs to the authors.

### İletişim | Communication

Trakya Üniversitesi İlahiyat Fakültesi Balkan Yerleşkesi 22030 Edirne- TÜRKİYE

Tel: 0 284 235 68 99 Fax: 0 284 235 08 87

rumelislam@trakya.edu.tr

<https://dergipark.org.tr/rumeli>

<https://rumeli.trakya.edu.tr/>

**RUMELİ**  
**İslâm Arařtırmaları Dergisi**  
**Journal of Islamic Studies**  
مجلة روم ايلي للبحوث الإسلامية

ISSN: 2564-7903

eISSN: 3023-8498

**SAHİBİ | OWNER**

Trakya Üniversiteler Birlięi İlahiyat Fakülteleri Adına

**Prof. Dr. Ali Öztürk**

Trakya Üniversitesi, İlahiyat Fakültesi

**EDİTÖR | EDITOR IN CHIEF**

**Dr. Mustafa Barış**

mustafabaris@trakya.edu.tr / Trakya Üniversitesi, İlahiyat Fakültesi

**YARDIMCI EDİTÖRLER | CO-EDITORS**

**Dr. Halil İbrahim Kaygısız**

hibrahimkaygisiz@trakya.edu.tr / Trakya Üniversitesi, İlahiyat Fakültesi

**Dr. Zehra Gözütok Tamdoğan**

ztamdogan@nku.edu.tr / Namık Kemal Üniversitesi, İlahiyat Fakültesi

**Dr. Sıddık Ağçoban**

s.agcoban@klu.edu.tr / Kırklareli Üniversitesi, İlahiyat Fakültesi

**YAZI İŞLERİ MÜDÜRÜ | RESPONSIBLE MANAGER**

**Dr. Nurullah Koltaş**

nurullahkoltas@trakya.edu.tr / Trakya Üniversitesi, İlahiyat Fakültesi

**REDAKSİYON / REDACTION**

**Dr. Uęur Boran**

ugurboran@trakya.edu.tr / Trakya Üniversitesi, İlahiyat Fakültesi



**Basım Tarihi / Printing Date**

**Ekim / October - 2024**



<https://rumeli.trakya.edu.tr/> <https://dergipark.org.tr/rumeli>



[rumelislam@trakya.edu.tr](mailto:rumelislam@trakya.edu.tr) [rumeliislam@rumeliislam](https://twitter.com/rumeliislam)

## Arařtırma Makaleleri / Articles

### NAHIJA E DRENICËS SIPAS DOKUMENTEVE OSMANE

Geliř Tarihi: 22 Mart 2024

Kabul Tarihi: 11 Temmuz 2024

Fahri AVDIJA \*

#### Abstrakti

Ky studim shqyrton rëndësinë historike dhe evolucionin administrativ të Nahijes së Drenicës nën Perandorinë Osmane gjatë shekullit të 19-të dhe fillimit të shekullit të 20-të. Nëpërmjet ekzaminimit të kujdesshëm të dokumenteve osmane, janë dhënë detaje të papublikuara deri më tani për fshatrat e rajonit, dinamikën sociale, demografinë dhe peizazhin ekonomik. Përmes këtij studimi, në të cilin rëndësi të veçantë i kushtohet tranzicionit administrativ të Nahijes së Drenicës, është shtjelluar historia e kalimit të saj nga kazaja e Vushtrisë nën kazanë e Mitrovicës, dhe më në fund kthimin e saj nën kazanë e Vushtrisë gjatë periudhës së vonë osmane. Duke hedhur dritë mbi këtë periudhë historike të Drenicës të pastudiuar sipas dokumenteve osmane, shpresojmë të përmbushet një zbrazëtitirë jetike në historinë e Kosovës. Ky studim, i bazuar kryesisht në të dhënat administrative dhe defteret osmane, ofron një analizë unike të së kaluarës së Drenicës.

**Fjalët çelësa:** Nahija e Drenicës, Vilajeti i Kosovës, Defteret Osmane, Perandoria Osmane.

### THE NAHIYE OF DRENICA IN OTTOMAN DOCUMENTS

#### Abstract

This study examines the historical significance and administrative evolution of the Drenica County under the Ottoman Empire during the 19th and early 20th centuries. Through careful examination of Ottoman documents, hitherto unpublished details of the region's villages, social dynamics, demography and economic landscape are provided. Through this study, in which special importance is given to the administrative transition of the Nahija of Drenica, the history of its transition from the district of Vushtrri under the district Mitrovica, and finally its return to district of Vushtrri during the late period, has been elaborated. By shedding light on this unstudied historical period of Drenica according to Ottoman documents, we hope to fill a vital void in the history of Kosovo. This study, based mainly on administrative records and Ottoman defters, offers a unique analysis of Drenica's past.

**Keywords:** The Nahiye of Drenica, The Vilayet of Kosova, Ottoman Defters, Ottoman Empire.

### OSMANLI BELGELERİNE GÖRE DRENİÇE NAHIYESİ

#### Özet

Bu çalışma, Dreniçe Nahiyesi'nin 19. yüzyılda Osmanlı İmparatorluğu yönetimindeki tarihsel önemini ve idari gelişimini incelemektedir. Osmanlı belgelerinin dikkatli bir şekilde incelenmesiyle bölgenin köyleri, sosyal dinamikleri, demografisi ve ekonomik durumu hakkında şimdiye kadar yayınlanmamış ayrıntılar ortaya çıkarılmıştır. Dreniçe Nahiyesi'nin idari geçişine özel önem verilen bu çalışma aracılığıyla, onun Vilçitrin kazasından Mitroviçe kazasına geçişi ve son olarak Osmanlı'nın son döneminde Vilçitrin kazasına dönüşünün tarihçesi ele alınmıştır.

\* Dr. Priştine Üniversitesi, Şarkiyat Bölümü, fahriavdija@hotmail.com

**ORCID ID:** 0000-0002-4506-7810

**DOI:** [10.53336/rumeli.1457145](https://doi.org/10.53336/rumeli.1457145).

**İntihal:** Bu makale "iThenticate" intihal tarama programında taranmış ve intihal içermediği tespit edilmiştir.

**Plagiarism:** This article has been scanned by iThenticate. No plagiarism detected.

**Atıf / Citation:** Avdija, Fahri. "Nahija E Drenicës Sipas Dokumenteve Osmane". *Rumeli İslâm Arařtırmaları Dergisi* 14 (2024), 9-20. <https://doi.org/10.53336/rumeli.1457145>.

**Copyright** © CC BY-NC 4.0

Dreniçe Nahiyesi ilk kez 19. yüzyılda Osmanlı belgelerinde karşımıza çıkıyor. İlk olarak 1 Ağustos 1832 tarihli nüfus defterlerinde ve daha sonra 1845 yılında Temettuat Defterleri'nde yer almaktadır.

Ancak, Osmanlı İmparatorluğu Balkanlar'da reform yönünde iç talepler ve dış baskılarla boğuşurken, Dreniçe Nahiyesi gibi küçük bölgelerde önemli idari değişiklikler yaşandı. Bunun kanıtı olarak Dreniçe'nin Mitroviçe kazasından ayrılıp Vılçitrin kazasının altında yeniden entegre edildiği 9 Mart 1889 tarihi gösterilebilir. Daha sonra 15 Kasım 1889'da Dreniçe'ye kaza statüsü verilir ve Priştine Sancağı'na bağlanır. Ancak bu reformlar sert bir muhalefetle karşılandı ve yeni idari düzene karşı şiddetli bir ayaklanmayla sonuçlandı. Verbofc köyü yakınlarında 7 Mayıs 1890'da yaşanan ayaklanma, iki Osmanlı askerinin hayatını kaybetmesiyle sonuçlanan idari yeniden yapılanmaya yönelik derin öfkeyi vurguluyor. Saldırımın arkasındaki nedenlere ilişkin, kabilelerin şikayetlerinden dış kışkırtıcılara kadar uzanan iddialarla çelişkili anlatılar ortaya çıkıyor. Ancak kaosu ortasında Dreniçe halkının dayanıklılığı, Osmanlı Devleti'ne bağlılıklarını ilan etmeleri ve saldırganları "eşkiya" olarak kınamalarıyla açıkça görülüyor.

Huzursuzluk karşısında Ferik Edhem Paşa, düzeni sağlamak ve 26 Kasım 1890'da Drenica Askeri Jandarma Teşkilatı'nı kurmak için hızla askeri kuvvetler konuşlandırarak bölgede istikrarın korunmasına yönelik çabaların sinyali verdi. Yönetim çabasının merkezinde Hükümet Konağı'nın inşası ve Tahir Paşa'nın Dreniçe'deki ilk kaymakamı olarak atanması yer alıyor.

Ancak hoşnutsuzluk devam ediyor ve Turiqefc köyü sakinlerinin belediye binasını ateşe vermesiyle sonuçlanan bir isyan eylemiyle sonuçlanıyor. Osmanlı hükümetinin tepkisi hızlı ve çok yönlü oldu; Priştine, Prizren ve İpek'ten gelen müdahaleler de buna dahildi. Sonunda, bunun gibi olaylar bir daha görmemek amacıyla, Dreniçe'nin tekrar başlangıçta olduğu gibi Vılçitrin Kazası'nın yetkisi altında tutulmasına karar verilmiştir.

Sonuç olarak Dreniçe'nin tarihi gidişatı, Osmanlı İmparatorluğu'ndaki idari reformların ve sosyopolitik direnişin karmaşıklığını özetlemektedir ve Osmanlı Devleti'ndeki kırsal bölgelerin idari değişimlerine dair değerli bilgiler sunmaktadır. Osmanlı belgelerine göre Dreniçe'nin incelenmemiş bu tarihi dönemine ışık tutarak, Kosova tarihinde çok önemli bir boşluğu doldurmayı umuyoruz. Esas olarak idari kayıtlara ve Osmanlı temettuat defterlerine dayanan bu çalışma, Dreniçe'nin geçmişine dair benzersiz bir çalışma sunmaktadır.

Osmanlı belgelerine göre Dreniçe'nin incelenmemiş bu tarihi dönemine ışık tutarak, Kosova tarihinde çok önemli bir boşluğu doldurmayı umuyoruz.

**Anahtar Kelimeler:** Dreniçe Nahiyesi, Kosova Vilayeti, Osmanlı Defterleri, Osmanlı İmparatorluğu.

## Hyrja

Shekulli i nëntëmbëdhjetë dëshmoi reforma të rëndësishme brenda Perandorisë Osmane, të cilat ishin të nxitura si nga presioni i jashtëm i Fuqive të Mëdha, ashtu edhe nga motivimet e brendshme. Më 1812, Sulltan Mahmudi II nisi përpjekjet për të vendosur autoritetin qendror, ndërsa përballë kishte fisnikët dhe pashallarët vendas. Deri në vitin 1826, më qëllim të formimit të një ushtrie të re, ai zbatoi reforma, duke krijuar provinca të njohura si *Müşiriyet* (Myshirijet) të qeverisur nga myshirët (marshallët), të cilët zotëronin autoritet të konsiderueshëm ushtarak dhe financiar. Shpallja e Tanzimatit e vitit 1839 riformësoi më tej qeverisjen, duke i transferuar çështjet financiare prodhuesve të pavarur. Kështu, autoriteti i marshallëve u kufizua në detyrën e rendit dhe sigurisë publike. Ndikimet perëndimore çuan në transformime të mëtejshme, duke përfshirë krijimin e këshillave administrative për të ndarë

përgjegjësitë e guvernatorëve dhe riorganizimin e *ejaleteve*<sup>1</sup> në *vilajete*<sup>2</sup> në vitin 1864.<sup>3</sup> Si rezultat i këtyre reformave, në trojet e banuara me shqiptarë u krijuan këto vilajete: Vilajeti i Shkodrës, Vilajeti i Shkupit, Vilajeti i Manastirit dhe Vilajeti i Prizrenit.<sup>4</sup> Ndërsa Vilajeti i Kosovës u krijua me 29 janar 1877 (14 Muharrem 1294).<sup>5</sup> Vilajeti i Kosovës brenda kufijve të tij fillimisht përfshinte Sofjen, Nishin dhe Prishtinën. Megjithatë, pas Luftës Ruso-Osmane të viteve 1877-1878, disa qytete të tjera u inkorporuan në territorin e saj.<sup>6</sup> Këto ndryshime kufitare janë shpjeguar nga Shemseddin Sami Frashëri në Kamus’ul-Alam si vijon: “*Vilajeti i Kosovës, me qendrat administrative në Sofje, Prishtinë dhe Nish, u krijua para Luftës Ruso-Turke (1877-1878). Pas luftës, qendra administrative u zhvendos në Prishtinë dhe Jeni Pazarit u përfshi në vilajet. Më pas, Sanxhaku i Prizrenit, duke u shkëputur nga Vilajeti i Manastirit, u bashkua me Vilajetin e Kosovës. Më në fund Peja me rrethinë mori statusin e sanxhakut dhe iu bashkua Vilajetit të Kosovës. Rrjedhimisht, qendra administrative e Vilajetit u zhvendos në Shkup.*”<sup>7</sup>

Vilajeti i Kosovës, i cili funksiononte si njësi territoriale dhe administrative brenda Perandorisë Osmane, përfshinte qytete të shumta që aktualisht ndodhen përtej Kosovës, duke mbuluar një sipërfaqe të përafërt prej 32,000 km<sup>2</sup>. Kufizohej me Austro-Hungarinë, Serbinë, Malin e Zi, Bullgarinë, Vilajetin e Shkodrës, Vilajetin e Manastirit dhe Vilajetin e Selanikut. Shikuar nga struktura administrative, ai përbëhej nga Sanxhaku i Prishtinës, Sanxhaku i Shkupit, Sanxhaku i Prizrenit, Sanxhaku i Jeni Pazarit dhe Sanxhaku i Dibrës.<sup>8</sup> Me kalimin e kohës, kufijtë territorialë të Vilajetit të Kosovës kanë pësuar ndryshime, herë duke u zgjeruar e herë duke u tkurrur. Ky transformim dinamik është i dukshëm në Kamus’ul-Alam, ku Shemseddin Sami Frashëri shkruan se në vitin 1896, Vilajeti i Kosovës përbëhej nga gjashtë sanxhaqe; Sanxhaku i Shkupit me kazatë: Shkup, Kaçanik, Ishtip, Koçanë, Orhaniye, Kratovë, Kumanova, Radovishte dhe Pallanka; Sanxhaku i Prishtinës me kazatë: Prishtinë, Vushtri dhe Mitrovicë; Sanxhaku i Prizrenit me kazatë: Prizren, Tetovë dhe Luma; Sanxhaku i Pejës me kazatë: Pejë, Gjakovë, Guci, Berane dhe Tregovishte; Sanxhaku i Jeni Pazarit me kazatë: Jeni

<sup>1</sup> Kjo shprehje rrjedh nga fjala arabe *ijale*, që do të thotë “të menaxhosh, të ekzekutosh”. Përdorimi zyrtar i këtij termi në lidhje me njësinë më të madhe administrative të osmanët fillon në fund të shekullit të 16-të. Për më shumë shih: Halil İnalçık, “Eyalet”, *Türkiye Diyanet Vakfı İslam Ansiklopedisi*, (Istanbul: TDV Yayınları, 1995), 11/550.

<sup>2</sup> İnalçık, “Eyalet”, 11/550.

<sup>3</sup> İnalçık, “Eyalet”, 11/550.

<sup>4</sup> Mucize Ünlü, *Kosova Vilayeti* (Ankara: Gece Kitaplığı, 2015), 23.

<sup>5</sup> Skender Rizaj, “Kosova Vilayeti Teşkilatı”, VII. *Türk Tarih Kongresi* (Ankara: Türk Tarih Kurumu, 1973), Vëllimi 2/666.

<sup>6</sup> Münir Aktepe, “Kosova”, *Türkiye Diyanet Vakfı İslam Ansiklopedisi*, (Ankara: TDV Yayınları, 2002), 26/218.

<sup>7</sup> Shemseddin Sami, *Kamus-ul A’lam* (İstanbul: 1896), 5/3748.

<sup>8</sup> Aktepe, “Kosova”, 26/218.

Pazar, Jeni Varosh, Kolashin dhe Akova; dhe Sanxhaku i Tashllëxhes me kazatë: Tashllëxha dhe Prepol.<sup>9</sup>

### Organizimi Administrativ i Vilajetit të Kosovës

Sanxhaku	Qendra administrative	Qytetet
Sanxhaku i Shkupit	Shkupi	Shkup, Kaçanik, Ishtip, Koçanë, Orhanije, Kratovë, Kumanovë, Radovishte dhe Pallanka
Sanxhaku i Prishtinës	Prishtina	Prishtinë, Vushtrri dhe Mitrovicë
Sanxhaku i Prizrenit	Prizreni	Prizren, Tetovë dhe Luma
Sanxhaku i Pejës	Peja	Pejë, Gjakovë, Guci, Berane dhe Tregovishte
Sanxhaku i Jeni Pazarit	Jeni Pazari	Jeni Pazar, Jeni Varosh, Kolashin dhe Akova
Sanxhaku i Tashllëxhas	Tashllëxha	Tashllëxha dhe Prepol

### Kalimi nga Nahije në Kaza: Evolucioni Administrativ i Drenicës

Katër njësitë kryesore administrative që përbënin bazën për ndarjen dhe menaxhimin e vilajeteve në Shtetin Osman ishin: *sanxhaku*<sup>10</sup>, *kazaja*<sup>11</sup>, *kasabaja*<sup>12</sup> dhe *nahija*<sup>13</sup>. *Nahija* nënkupton një rajon ose njësi specifike gjeografike/administrative brenda Shtetit Osman, që zakonisht përfshin një territor më të vogël në krahasim me kazanë, por që përfshin një numër të konsiderueshëm fshatrash. Njëra ndër nahijet më të rëndësishme në Vilajetin e Kosovës, për të cilën do të flasim në vijim, është Nahija e Drenicës.

Toponimi Drenicë, respektivisht Nahija e Drenicës në defteret osmane të shekullit të 19-të kalon si *Dreniçe Nahiyesi*. Konkretisht figuron në një regjistër popullsie të datës 1 gusht

<sup>9</sup> Sami, 5/3748.

<sup>10</sup> Fjala sanxhak, rrjedh nga folja turke *sançmak*, që do të thotë flamur apo ndarja administrative osmane e cila drejtohej nga një mutasarref. Për më shumë shih İlhan Şahin, “Sancak”, *Türkiye Diyanet Vakfı İslam Ansiklopedisi* (İstanbul: TDV Yayınları, 2009), 36/97.

<sup>11</sup> Një vend që ishte nën sundimin dhe administrimin e një kadiu (gjykatësi), ndërsa në periudhën e fundit osmane drejtohej nga një qeveritar qarku (Kajmakam). Për më shumë shih Tuncer Baykara, “Kaza”, *Türkiye Diyanet Vakfı İslam Ansiklopedisi* (Ankara: TDV Yayınları, 2022), 25/119.

<sup>12</sup> Një vendbanim i vogël, midis një fshati dhe një qyteti për nga madhësia, qytezë. Për më shumë shih Tuncer Baykara, “Kasaba”, *Türkiye Diyanet Vakfı İslam Ansiklopedisi* (Ankara: TDV Yayınları, 2001), 24/525.

<sup>13</sup> Fjala nahije, që do të thotë anë, drejtim, lokalitet, rajon, herë i referohet një njësie dhe rajoni administrativ dhe herë një mjedisi, rajoni apo edhe rrethi në sistemin administrativ osman të vogël apo të madh gjeografikisht. Pas Tanzimatit, më së shumti përdorej për njësi të vogla administrative të cilat ishin pak më të vogla se *kazaja*. Për më shumë shih İlhan Şahin, “Nahiye”, *Türkiye Diyanet Vakfı İslam Ansiklopedisi* (İstanbul: TDV Yayınları, 2006), 32/306.



1832.<sup>14</sup> Përveç kësaj, në vitin 1845 e hasim edhe në Regjistrat e *Temettuateve*<sup>15</sup>, të cilat japin informacione jetike për fshatrat e Nahijes së Drenicës. Këto informacione përfshijnë emrat e fshatrave, emrat e kryefamiljarëve, pasuritë familjare dhe detajet e taksave të paguara Shtetit Osman nga çdo familje.<sup>16</sup>

Megjithatë, për shkak të reformave të ndryshme në Perandorinë Osmane, shpesh nën presionin e Fuqive të Mëdha ose si rezultat i kërkesave të brendshme, territori i Kosovës pësoi disa ndryshime në ndarjet administrative. Rrjedhimisht edhe Drenica kaloi nga disa qytete apo njësi administrative nën disa të tjera. Kjo është veçanërisht e dukshme në një dokument të datës 9 mars 1889, i cili tregon se Drenica u nda nga Mitrovica dhe u rikthye nën juridiksionin e Vushtrrisë.<sup>17</sup> Sipas dokumentit të cilin e shkruan Sadriazemi (kryeministri) osman, kuptojmë se ky ndryshim administrativ erdhi si përgjigje ndaj kërkesës së banorëve të kësaj zone parashtruar me 22 gusht 1888.<sup>18</sup> Një vit më vonë, më 15 nëntor 1889, Drenicës iu dha statusi i kazasë dhe u mor vendimi që ajo të bëhej pjesë e sanxhakat të Prishtinës.<sup>19</sup> Krahas këtyre zhvillimeve, një grup individësh nga fshatra të ndryshme të Drenicës u revoltuan kundër këtij vendimi. Ky kundërshtim i tyre ndaj ndryshimit administrativ i shtyu të ndërmerrnin veprime kundër zëvendësit të kajmekamit të Drenicës, ndërsa ai ishte rrugës për në qendër të kazasë së sapokrijuar.<sup>20</sup> Ngjarja ka ndodhur më 7 maj 1890, në afërsi të fshatit Verbofc, ku dy ushtarë osmanë, të cilët ishin duke përcjellur zëvendës kajmekamin, humbën jetën në një sulm të papritur të kryer nga grupi i individëve të lartpërmendur.<sup>21</sup> Sipas dokumentit drejtuar zëvendësit të kajmekamit të Drenicës, është e evidente se sulmuesit ishin anëtarë të pesë fiseve me origjinë nga Drenica. Këta persona supozohet se janë nxitur për të kryer sulmin nga një individ i quajtur Abdurrahman Aga, me prejardhje nga Vushtrria,<sup>22</sup> duke shprehur gjoja *pakënaqësinë e tyre për ndarjen e Drenicës nga kazaja e Vushtrrisë*. Megjithatë, një dokument nga një datë e mëvonshme (10 shkurt 1891) kundërshton këtë narrativë, duke thënë se në të vërtetë ishte një grup i vogël *banditësh* që kreu sulmin. Sipas një telegrami të dërguar nga

<sup>14</sup> NFS.d. 5726

<sup>15</sup> Janë dokumente zyrtare të përgatitura në periudhën e Tanzimatit për të regjistruar banorët e një rrethine, kafshët që ata kishin në pronësi, tokën dhe të gjithë pasuritë tjera të banorëve të një regjioni të caktuar.

<sup>16</sup> Başkanlık Osmanlı Arşivi (BOA), *Maliye Nezareti Defterleri [ML.VRD.TMT.d.]*, No. 15478.

<sup>17</sup> BOA, *Dahiliye Mektubi Kalemi [DH.MKT.]*, No. 1609, Gömlek No. 13, 1; BOA, *DH.MKT*, No. 1619, Gömlek No. 5, 1.

<sup>18</sup> BOA, *DH.MKT*, No. 1609, Gömlek No. 13, 1.

<sup>19</sup> BOA, *Mecli-i Vükela Mazbataları [MV]*, No. 54, Gömlek No. 56, 1.

<sup>20</sup> Sipas dokumentit BOA, *Yıldız Mütenevvi Maruzat [Y.MTV.]*, No. 43. Gömlek No. 118, 9. kuptojmë se qendër e kazasë së Drenicës ishte zgjedhur fshati Llaushë. Aryeja mund të jetë numri më i madh i popullsisë që kishte ky fshat krahas fshatrave tjera.

<sup>21</sup> BOA, *Y.MTV*, No. 43, Gömlek No. 118, 2.

<sup>22</sup> BOA, *Y.MTV*, No. 43, Gömlek No. 118, 4.

përfaqësues të fshatrave të Drenicës komandantit të forcave osmane në rajon, Dervish Pashës, thuhet se banorët e Drenicës janë besnikë ndaj Shtetit Osman. Telegrami pohon se sulmuesit ishin një grup banditësh të cilët duhet të dënohen në përputhje me rrethanat. Përveç kësaj, dokumenti përmban emrat dhe nënshkrimet e përfaqësuesve të fshatrave të Drenicës.<sup>23</sup>

Pas këtij sulmi, Ferik Edhem Pasha, komandanti i forcave ushtarake në Vilajetin e Kosovës, u kundërpërgjigj me shpejtësi duke dërguar një ushtri në zonë. Trupat u vendosën për të siguruar rendin dhe për të stabilizuar situatën në rajon.<sup>24</sup> Më 14 maj 1890, zëvendës kajmekami me shoqëruesit e tij udhëtuan për në fshatin Llaushë, i cili asokohe shërbente si qendër administrative e Kazasë së Drenicës,<sup>25</sup> ndërsa më 16 qershor 1890, në kazanë e Drenicës u zgjodh edhe një zyrtar përgjegjës për çështjet ekonomike.<sup>26</sup>

Për të parandaluar përsëritjen e së njëjtës situatë si ajo e sulmit ndaj punonjësve të administratës osmane dhe për të ruajtur rendin dhe sigurinë në vend, më 26 nëntor 1890 u krijua Xhandarmëria Ushtarake e Drenicës.<sup>27</sup>

Kajmekami i parë Drenicës ishte Tahir Efendiu, për të cilin thuhet se ishte nga Anadulli, konkretisht nga kazaja Balja që sot gjendët në qytetin Ballëkesir në afërsi të qytetit Bursa. Pas përfundimit të Sibjan Mektebit (shkollës fillore), Tahir Pasha kishte vazhduar të merrte mësim nga dijetarët e kohës. Fliste arabisht, persisht dhe turqisht.<sup>28</sup> Në vitin 1890, ndërsa shërbente si kajmekam i Drenicës, Tahir Efendiu nisi ndërtimin e një mulliri në rajon. Në rrethana të panjohura, thuhet se tensionet mes tij dhe popullatës lokale çuan në shkarkimin e tij nga detyra.<sup>29</sup> Megjithatë, pavarësisht raporteve kontradiktore, një dokument tjetër sugjeron se ai e mbajti postin e kajmekamit të Drenicës deri në vitin 1892, pas të cilës datë u emërua kajmekam në kazanë e Kushadës në Anadoll.<sup>30</sup>

### **Ndërtimi i Konakut të Hyqymetit**

Për të vendosur një qeverisje efektive, ndërtimi i *Konakut të Hyqymetit* (ndërtesë komunale) u konsiderua thelbësor. Kjo ndërtesë do të shërbente si gurthemeli i administratës vendore, duke ofruar një qendër për aktivitetet qeveritare, mbledhjet dhe proceset e vendimmartjes. Ajo simbolizon autoritetin e pushtetit dhe përfaqëson një angazhim të

<sup>23</sup> BOA, *Yıldız Umumi [Y.PRK.UM.]*, No. 20, Gömlek No. 102.

<sup>24</sup> BOA, *Y.MTV*, No. 43, Gömlek No. 118, 1.

<sup>25</sup> BOA, *Y.MTV*, No. 43, Gömlek No. 118, 9.

<sup>26</sup> BOA, *DH.MKT*, No. 1734, Gömlek No. 120, 1.

<sup>27</sup> BOA, *İrade Dahiliye [İ.DH.]*, No. 1205, Gömlek No. 94295.


<sup>28</sup> BOA, *İ.DH.*, No. 1187, Gömlek No. 92922, 1.

<sup>29</sup> BOA, *İ.DH.*, No. 1187, Gömlek No. 92922, 2; *İ.DH.*, No. 1187, Gömlek No. 92922, 3; *İ.DH.*, No. 1187, Gömlek No. 92922, 4.

<sup>30</sup> BOA, *DH.MKT*, No. 2036, Gömlek No. 11, 1.

prekshëm për qeverisjen e organizuar brenda rajonit. Për më tepër, ndërtimi i *Konakut të Hyqymetit* në Drenicë pasqyroi një iniciativë më të gjerë për të vendosur kontrollin dhe rendin, në mes të një sfondi të ristrukturimit administrativ dhe ndryshimit të dinamikës politike. Duke pasur parasysh faktin se ishte fshati më i dendur, Llausha u përcaktua fshati në të cilin do të ndërtohej *Konaku i Hyqymetit*. Ndërtimi filloi më 27 qershor 1890,<sup>31</sup> me pjesmarrjen e njëzet punëtorëve të ardhur nga Prishtina.<sup>32</sup>

Foto 1. Plani i *Konakut të Hyqymetit* në Drenicë



Pas kësaj, pakënaqësia me vendimin për kthimin e Nahijes së Drenicës në kaza dhe ndërtimit të Konakut të Hyqymetit u intensifikua te banorët e rajonit, duke arritur kulmin me një akt rebelimi. Disa persona nga fshati Turiqefc (sot pjesë e komunës së Skenderajt), nën udhëheqjen e Ramo Lutës dhe Tahir Bajraktarit, i vunë zjarrin ndërtesës së komunës. Si kundërpërgjigje ndaj kësaj, pushteti osman ndërmori veprimet fillimisht nga Prishtina, më pas nga Prizreni dhe Peja. Më 30 mars 1891, Mytesarifi i Pejës, Ymer Pasha, mblodhi individë të besuar dhe zbriti në fshatin Llaushë për të shuar kryengritjen.<sup>33</sup> Ndryshe, sipas një tregimi tjetër, Ymer Pasha dërgoi Haxhi Zejnel Efendiun nga sanxhaku i Pejës, i cili shtypi kryengritjen dhe tentoi ta integronte Drenicën në sanxhakun e Pejës.<sup>34</sup> Megjithatë, banorët e Drenicës përmes lutjes shprehën shqetësimin se lidhja e Drenicës me sanxhakun e Pejës *do t'i*

<sup>31</sup> BOA, *Y.PRK.UM*, No. 49, Gömlek No. 106, 1.

<sup>32</sup> BOA, *İ.MMS*, No. 114, Gömlek No. 4905, 3.

<sup>33</sup> BOA, *Yıldız Arzuhal Jurnal [Y.PRK.AZJ]*, No. 18, Gömlek No. 88, 2.

<sup>34</sup> BOA, *Y.PRK.AZJ*, No. 18, Gömlek No. 88, 1.

*përkeqësonte problemet ekzistuese*. Rrjedhimisht, u vendos që Drenica të mbetej nën juridiksionin e sanxhakut të Prishtinës.<sup>35</sup>

Pavarësisht përpjekjeve për të stabilizuar situatën, trazirat në Drenicë vazhduan, duke pamundësuar funksionimin e qeverisjes lokale. Kështu, u mor vendim që Drenicës t'i kthehej statusi i nahijes, duke e vendosur sërish nën kazanë e Vushtrrisë, me qendër fshatin Firuz Bej. Ky vendim u zyrtarizua më 8 qershor 1892, me fillimin e kalimit të funksioneve administrative nga Llausha në fshatin Firuz Bey.<sup>36</sup>

### **Fshatrat e Drenicës sipas *Deftereve Temettuat***

Në këtë segment, do të ofrojmë një pasqyrë të shkurtër të fshatrave të Drenicës gjatë periudhës osmane, duke nxjerrë njohuri nga depoja e pasur e *Deftereve Temettuat*. Ndërsa nuk do të thellohem në detaje shteruese, është e rëndësishme të theksohet se në artikullin tonë të radhës do të fokusohemi ekskluzivisht në eksplorimin e *Defterëve Temettuat* të Drenicës, duke ofruar një analizë gjithëpërfshirëse të rëndësisë së tyre në kuptimin e narrativës historike të Drenicës.

Sipas këtij defteri, Drenica përfshinte gjithsej 61 fshatra. Katër prej këtyre fshatrave nuk kemi arritur t'i zbulojmë, ndërsa 57 të tjerat edhe sot mbajnë të njejtin emër, më përjashtim të disa dallimeve në prapashtesa të emrave. Faqja e parë e këtij defteri është e zbrazët ndërsa të dhënat fillojnë nga faqja e dytë. Regjistri fillon me të dhëna bazike duke treguar që Drenica ishte pjesë e kazasë së Vushtrrisë, ndërsa Vushtrria ishte nën sanxhakun e Prishtinës, kurse kjo e fundit bënte pjesë në Ejaletin e Shkupit.<sup>37</sup> Emrat e fshatrave janë shkruar pa ndonjë rënditje alfabetike apo pa u nisur nga madhësia apo rëndësia që mund të kishin. Fillon me fshatin *Pluzhinë/Plluzhinë* ndërsa mbaron me fshatin *Kires/Qirez*, që të dyja sot pjesë e komunës së Skënderajt.

Në listën e sjellur më poshtë, e cila është marrë nga *Defteri Temettuat* i Drenicës dhe mbanë numrin 15478, janë dhënë emrat e fshatrave të Nahijes së Drenicës, ndërsa rënditja është bërë sipas numrit rendor që gjenden në defter.

Tabela 1: Fshatrat në Nahijen e Drenicës sipas defterit më numër ML.VRD.TMT.d.15478

<b>Numri rëndor</b>	<b>Emri i fshatrave sipas defterit</b>	<b>Numri sipas defterit</b>	<b>Emrat e tanishëm</b>
1	Plluzhinë	2	Plluzhinë
2	Tiçe	6	Ticë
3	Likofçe	7	Likofc
4	Tushile	10	Tushilë

<sup>35</sup> BOA, *Y.PRK.AZJ*, No. 18, Gömlek No. 88, 1; *Y.PRK.AYJ*, No. 18, Gömlek No. 88, 2.

<sup>36</sup> BOA, *DH.MKT*, No. 2036, Gömlek No. 11, 1.

<sup>37</sup> BOA, *ML.VRD.TMT.d*, No. 15478.

5	Terdefçe	10	Tërdefc
6	Obrine	12	Obri
7	?	21	I panjohur
8	Terstenik	21	Terstenik
9	?	30	I panjohur
10	Kurotinçe	31	Korroticë
11	Çikatova	35	Çikatovë
12	Llavusha	39	Llaushë
13	Ofçareva	49	Açarevë
14	Kopilik	53	Kopiliq
15	Turishefçe	57	Turiqefc
16	Burokne	60	Burojë
17	Klladrinçe	63	Kllodernicë
18	Kopilik-i Bala	68	Kopiliq i Epërm
19	Rakinçe	70	Rakinicë
20	Çubrel	72	Çubrel
21	Vitak	77	Vitak
22	Radisheve	81	Radishevë
23	Kotor	82	Kotorr
24	Rezall	86	Rezallë
25	Mokirmal	92	Makermal
26	Marine	92	Marinë
27	Kurushevçe	94	Kryshfc
28	Kline-i Zir	95	Klinë e Ulët
29	Kline-i Bala	100	Klinë e Epërme
30	Kline-i Orta	104	Klinë e Mesme
31	Koçiçe	106	Kuçicë
32	Dubofçe	109	Dubofc
33	Polançe	114	Polac
34	Prekaz-i Bala	121	Prekaz i Epërm
35	Prekaz-i Zir	12	Prekaz i Ulët
36	Krasilik	129	Krasaliq
37	Ternaçe	130	Tërnafc
38	Galinçe	132	Galicë
39	Mikushniçe	134	Mikushnicë
40	Bakse	136	Baks
41	Beçik	138	Beçiq
42	Prelofçe	138	Prelofc
43	Kozhinçe	139	Kozhicë
44	Doshefçe	140	Doshefc
45	Ishtutinçe	141	Shtuticë
46	Virbofçe	143	Verbofc
47	Likoshan	147	Likoshan
48	Pulluzhine	151	Plluzhinë
49	Krajkova	152	Krajkovë
50	?	155	I panjohur
51	Bajinçe	156	Baicë
52	?	161	I panjohur
53	Gllabar	162	Gllabar
54	Gllagofçe	166	Drenas
55	Poklak	173	Poklek
56	Vasilevo	176	Vasilevë
57	Dobroshefçe	177	Dobroshefc

58	Gllanosel	181	Gllanasellë
59	Gradinçe-i Zir	186	Gradicë e Ulët
60	Gradinçe-i Bala	187	Gradicë e Epërme
61	Kires	190	Qirez

### Konkluzioni

Drenica, e cila gjeografikisht ndodhet në qendër të Kosovës, është një vend me rëndësi strategjike. E integruar në qeverisjen osmane krahas rajoneve tjera, Drenica pësoi ndryshime të mëdha administrative në fillim të shekullit të 19-të. Si rezultat i faktorëve të tillë si vendndodhja strategjike, shtrirja territoriale dhe dinamika demografike, ky rajon kaloi midis statuseve të nahijes dhe kazasë. Për shkak të kryengritjeve të ndryshme dhe konflikteve të brendshme, Drenicës iu rikthye statusi i nahijes, duke pasqyruar kështu një pjesë të historisë komplekse dhe të trazuar të rajonit. Kryengritje e banorëve vendas shërbeu si një shembull i kompleksiteteve të qenësishme në procesin e reformave administrative dhe sfidave të pajtimit të interesave të ndryshme brenda një komuniteti.

Por si përfundim, Drenica mbeti si nahije brënda kazasë së Vushtrrisë deri në shkëputjen e Kosovës nga Përandoria Osmane me 1912.

### Literatura

- BOA, Başkanlık Osmanlı Arşivi. *Maliye Nezareti Defterleri [ML.VRD.TMT.d.]*, No. 15478.
- Dahiliye Mektubi Kalemi [DH.MKT.]*, No. 1609, Gömlek No. 13, 1; *DH.MKT*, No. 1619, Gömlek No. 5, 1; *DH.MKT*, No. 1609, Gömlek No. 13, 1; *DH.MKT*, No. 1734, Gömlek No. 120, 1; *DH.MKT*, No. 2036, Gömlek No. 11, 1.
- Mecli-i Vükela Mazbataları [MV]*, No. 54, Gömlek No. 56, 1.
- İrade Meclis-i Mahsus [İ.MMS.]*, No. 114, Gömlek No. 4905, 2; *İ.MMS*, No. 114, Gömlek No. 4905, 3.
- İrade Dahiliye [İ.DH.]*, No. 1187, Gömlek No. 92922, 1; *İ.DH*, No. 1187, Gömlek No. 92922, 2; *İ.DH*, No. 1187, Gömlek No. 92922, 3; *İ.DH*, No. 1187, Gömlek No. 92922, 4.
- Yıldız Mütenevvi Maruzat [Y.MTV.]*, No. 43. Gömlek No. 118, 9; *Y.MTV*, No. 43, Gömlek No. 118, 2; *Y.MTV*, No. 43, Gömlek No. 118, 4; *Y.MTV*, No. 43, Gömlek No. 118, 1; *Y.MTV*, No. 43, Gömlek No. 118, 9.
- Yıldız Arzuhal Jurnal [Y.PRK.AZJ]*, No. 18, Gömlek No. 88, 2; *Y.PRK.AZJ*, No. 18, Gömlek No. 88, 1; *Y.PRK.AZJ*, No. 18, Gömlek No. 88, 1; *Y.PRK.AYJ*, No. 18, Gömlek No. 88, 2.
- Yıldız Umumi [Y.PRK.UM.]*, No. 49, Gömlek No. 106, 1.

Aktepe, Münir. “Kosova”. *Türkiye Diyanet Vakfı İslam Ansiklopedisi*. 26/216-219. Ankara: TDV Yayınları, 2002.

Baykara, Tuncer. “Kaza”. *Türkiye Diyanet Vakfı İslam Ansiklopedisi*. 25/119-120. Ankara: TDV Yayınları, 2022.

Baykara, Tuncer. “Kasaba”. *Türkiye Diyanet Vakfı İslam Ansiklopedisi*. 24/525-526. Ankara: TDV Yayınları, 2001.

İnalçık, Halil. “Eyalet”. *Türkiye Diyanet Vakfı İslam Ansiklopedisi*. 11/548-550. İstanbul: TDV Yayınları, 1995.

Rizaj, Skender. “Kosova Vilayeti Teşkilatı”. *VII. Türk Tarih Kongresi Bildirileri*. 2/665-670. Ankara: Türk Tarihi Yayınları, 1973.

Sami, Shemseddin. *Kamus-ul A'lam 5*. İstanbul: 1896.

Şahin, İlhan. “Sancak”. *Türkiye Diyanet Vakfı İslam Ansiklopedisi*. 36/97-99. İstanbul: TDV Yayınları, 2009.

Şahin, İlhan. “Nahiye”. *Türkiye Diyanet Vakfı İslam Ansiklopedisi*. 32/306-308. İstanbul: TDV Yayınları, 2006.

Ünlü, Mucize. *Kosova Vilayeti*. Ankara: Gece Kitaplığı, 2015.

Shtojca



ML.VRD.TMT.d.15478

Faqja e parë dhe e dytë e Defterit Temettuat të Nahijes së Drenicës